



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.479/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesat e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj, Dardan Shala, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhen si të pas afatshme ankesat e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Skenderaj, Dardan Shala, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, ZL.A.nr.479/2017, ZL.A.nr.480/2017, ZL.A.nr.481/2017, ZL.A.nr.482/2017, ZL.A.nr.483/2017, ZL.A.nr.484/2017, ZL.A.nr.485/2017, ZL.A.nr.486/2017, ZL.A.nr.487/2017 dhe ZL.A.nr.488/2017, të paraqitura me datë 24.10.2017, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2017, PZAP-i ka pranuar 10 (dhjetë) ankesa nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj, Dardan Shala, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, me të cilat pretendon se ka pasur parregullsi në Qendrat e Votimit në Skenderaj, si në: Likofc 2112B/02D, 2112B/01R, Prekaz i Epërm 2105B/04D, 2105B/01R, Abri e Poshtme 2121B/02D, 2121B/01R, Qubrel 2102B/02D, 2102B/01R, janë bërë parregullsi në ditën e votimit.

Paneli i PZAP -it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.479/2017, për shkak të ekonomizimit të procedurës, pasi kemi të bëjmë me karakterin e njëjtë të rasteve (formati A5 i njoftimit), ndaj të njëjtit subjekt politik dhe pretendimeve të njëjta ankimore.

Paneli pas shqyrtimit të afatshmërisë, gjeti se:

Ankesat janë të pasafatshme.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të ankesave, ka gjetur se ankesat e parashtruara nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj, Dardan Shala, nga radhët e subjektit politik AAK, janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 5.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ku përcaktohet: “Ankesat në lidhje me procesin zgjedhor për ditën e votimit parashtrohen pranë PZAP-së brenda njëzetekatër (24) nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit”. Ngase prej shkresave të lëndës del se shkeljet e pretenduara nga subjekti politik LVV, janë bërë me 22.10.2017. Afati për ankesa ka qenë 24 orë nga shkelja e supozuar. Ankesat në PZAP nga Dardan Shala, janë paraqitur me datë 24.10.2017, çka do të thotë 1 (një) ditë pas afatit të përcaktuar në dispozitën e nenit 5.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së dhe nenin 5 par.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.A.nr. 479/2017 më datën 24.10.2017



Kryesues i Panelit
Zyhëri Haziri

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.